



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I TELEKOMUNIKACIONEVE

RREGULLORE

**“ Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL
dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”**

INDEKSI I PERMBAJTJES

Të përgjithshme	3
Neni 1 – Përkufizime	3
Neni 2 – Objekti	6
Neni 3 – Zbatueshmëria	6
Neni 4 – Kushtet dhe kërkesat e përgjithshme	6
Neni 5 – Periudha kalimtare (Sunrise period)	7
Neni 6 – Kategoritë e Domain-eve	8
Neni 7 – Poseduesi i një emri domain-i në zonën “.al”	9
Neni 8 – Kontakti administrativ	9
Neni 9 – Mundësi kontakti	9
Neni 10 – Rinovimi i informacionit	10
Neni 11 – Të drejtat mbi emrin e domain-it	10
Neni 12 – Vlefshmëria e emrit të domain-it	11
Neni 13 – Kushtet në zonen “.al”	11
Neni 14 – Regjistrimi i një emri domain-i në zonën .gov.al, .mil.al dhe .edu.al	11
Neni 15 – Rregulla të vecanta për nën domain-in .gov.al	12
Neni 16 – Rregulla të vecanta për nën domain-in .mil.al	12
Neni 17 – Rregulla të vecanta për nën domain-in .edu.al	12
Neni 18 – Zgjedhja e emrit të domain-it	13
Neni 19 – Emrat e ndaluar dhe te rezervuar	13
Neni 20 – Rregullat sintaksore	14
Neni 21 – Regjistrimi i emrit të domain-it	14
Neni 22 – Kriteret e regjistrimit	15
Neni 23 – Faturimi i pagesave për regjistrimin dhe posedimin e emrave të domain-eve	15
Neni 24 – Pezullimi i veprimeve	16
Neni 25 – Bllokimi i një emri domain-i	17
Neni 26 – Mbyllja e një emri domain-i	17
Neni 27 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	19
Neni 28 – Modifikimi teknik	19
Neni 29 – Transferimi vullnetar i emrit të domain-it	19
Neni 30 – Transferimi i detyrueshëm i emrit të domain-it	20
Neni 31 – Detyrimet e poseduesit të ri pas transferimit të emrit të domain-i.....	21
Neni 32 – Konfidencialiteti dhe ruajtja e privacisë	21
Neni 33 – Te dhënat personale	21
Neni 34 – Detyrimet	22
Neni 35 – Garancitë	22
Neni 36 – Modifikimi i Rregullores	22
Neni 37 – Ligjshmëria	23
Neni 38 – Dispozitë perfundimtare	23
ANEKS 1 – Dispozitat mbi të cilat do të bëhet regjistrimi i emrave të domain-eve gjatë periudhës kalimtare (sunrise period)	24-25

Të përgjithshme:

1. Enti Regulator i Telekomunikacioneve (ERT) është “**Autoriteti Përgjegjës**” për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nën domain-et “.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”.
2. Emrat e domain-eve janë të regjistrueshëm në shërbim të interesit të përgjithshëm të publikut në përputhje legjislacionin për publikimin dhe mosdiskriminimin, me qëllimin për të siguruar veçanarisht mbrojtjen e pronësisë intelektuale.
3. Për këtë qëllim, Autoriteti Përgjegjës nxjerr këtë Rregullore për të administruar regjistrimin dhe mirëmbajtjen e emrave të domain-eve nën “.al” dhe gjashtë nën domain-et përkatëse.
4. Rregullorja, së bashku me formularët dhe çdo dokument tjetër mbështetës, formojnë një akt të vetëm normativ të quajtur “Rregullore për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.al” dhe nën domain-et “.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” (këtu dhe më poshtë e njohur si “**Rregullorja**”).
5. Subjekte të së drejtës për të poseduar një ose disa emra domain-esh nën administrimin e Autoritetit Përgjegjës sipas kësaj Rregulloreje në zonën e “.al” dhe nën domain-et “.com.al, .org.al dhe .net.al”, janë personat juridikë publikë dhe privatë, si dhe personat fizikë tregtar.
6. Personat fizik (jo tregtar) në kuptim të përcaktimit të parashikuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, do të përfshihen si subjekte që kanë të drejtë të aplikojnë dhe posedojnë një ose disa emra domain-esh sipas Rregullores, në një periudhë të mëvonshme, fillimi i së cilës do të vendoset dhe bëhet i ditur për të interesuarit nga Autoriteti Përgjegjës.
6. Numri i domain-eve që mund të posedojnë në përdorim një subjekt sipas kësaj Rregulloreje është i pakufizuar.

Neni 1 Përkufizime

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.1 “**Autoriteti Përgjegjës**” - është Enti Regulator i Telekomunikacioneve (ERT) sipas ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili do të bëjë regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nën domain-et “.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, si dhe mbikqyrjen e zbatimit të Rregullores nga subjektet e autorizuara prej tij për të bërë regjistrime të këtyre domain-eve dhe nën domain-eve.

1.2 **“aplikuesi”** – është çdo person juridik publik dhe privat si dhe çdo person fizik tregtar i cili paraqet tek Autoriteti Përgjegjës kërkesën për regjistrimin apo transferimin e një ose më shumë emra domain-esh.

1.3 **“adrese IP”** – “Internet Protocol Address”, gjithashtu e njohur si “Internet Address”, është një adresë unike e përdorur për të identifikuar një burim (p.sh. kompjuter, router, etj) në Internet. Kjo adresë përbëhet nga një numër (sekuence) shifrash.

1.4 **“bllokim”** – është veprimi i cili përfshin mbylljen (tërheqjen) dhe ç’aktivizimin e përkohshëm të emrit të domainit nga shërbimi DNS, duke e bërë atë jo të përdorshëm deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi kompetent. Në këtë gjendje (status) emri i domain-it vazhdon t’i përkasë poseduesit të tij dhe si rrjedhim, emri i domain-i, të bllokuar nuk mund të regjistrohet nga ndonjë palë tjetër.

1.5 **“DNS”** – Domain Name System (sistem/shërbim i emrave të domain-eve), është një bazë të dhënash e shpërndarë që përdoret për regjistrimin e burimeve të Internetit (kompjuter, router, etj) në formën e një emri domain-i (p.sh. nic.al) dhe i përputh ato me një adresë Interneti. Si rrjedhim, protokollin e Internetit kryen konvertimin midis emrit të domain-it dhe adresave të Internetit të makinave të lidhura në Internet.

1.6 **“DNS server”** – Name Server (NS) (shërbyes emrash), është një server (shërbyes) që përdoret për të regjistruar emrat e domain-eve. Ka dy lloje server-ash për emrat e domain-eve: server-a parësor (primary) dhe dytësor (secondary).

1.7 **“emërtimi”** – është veprimi që kryhet për përcaktimin e emrave të domain-eve nëpërmjet zbatimit të rregullave të parashikuara në këtë Rregullore. Këto rregulla ndryshojnë sipas institucioneve të autorizuar për të administruar zona të Internetit (.al: ERT, .fr: AFNIC, .uk: Nominet, etj)

1.8 **“emri domain-i”** – është një kombinim alfanumerik që përbëhet nga një rrënjë dhe një shtesë që përputhet me një adresë Interneti.

1.9 **“gjendje”** – është një gjendje(status) e tillë që përcakton veprimet e mundëshme që mund të kryhen mbi një emri domain-i dhe e funksionimit të tij. Kemi tre gjendje(statuse):

- a) **AKTIV:** Emri i domain-it është i deklaruar në DNS (me funksionim të plotë)
- b) **PEZULLUAR:** Emri i domain-it është i deklaruar në DNS, por asnjë veprim administrativ nuk mund të kryhet mbi të.
- c) **BLOKUAR:** Emri i domain-it nuk është me i deklaruar në DNS. Nuk është më funksional dhe nuk mund të kryhet asnjë veprim administrativ mbi të.

1.10 **“identifikim i pasuksesshëm”** – konsiderohet rezultati i veprimit të identifikimit, kur në përfundim të procesit të verifikimit të kryer nga Autoriteti Përgjegjës, të dhënat e deklaruara në formularët e aplikimit nga poseduesi i emrit të domain-it nuk janë të njëjtë (ose nuk arrijnë të vërtetohet), me bazën e të dhënave publike (informacionit) që disponojnë institucionet e caktuara ligjërisht për këtë qëllim. Kjo, në mënyrë të veçantë kur informacioni i depozituar nga poseduesi i emrit të domain-it nuk gjendet në këto baza

të dhënash (*data base*) të institucioneve publike/shtetërore përgjegjëse, është i ndryshëm, ose kur për çfardolloj arsyeje nuk mund të arrihet të hyhet në bazën e të dhënave përkatëse.

1.11 “**modifikim teknik**” – është procesi/veprimi teknik që përfshin modifikimin e serverave DNS në të cilët është instaluar emri i domain-it.

1.12 “**mbyllja**” – është veprimi i cili përfshin mbylljen (tërheqjen) e emrit të domain-it nga shërbimi DNS dhe kthimin e tij, tashmë jo funksional, në gjendje të lirë për t’u regjistruar nga një aplikant i ri.

1.13 “**posedues**” – është aplikuesi që pas regjistrimit të një ose disa emra domain-esh e/i ka atë/ato në përdorim efektiv sipas kushteve të kësaj Rregulloreje.

1.14 “**pezullimi i veprimeve**” – është masë administrative e përkohshme që vendoset mbi veprimet administrative që kryhen nga Autoriteti Përgjegjës mbi një emer domain-i. Gjendja e pezullimit nuk ndikon në përdorimin e emrit të domain-it (funksionimi normal i faqes së Internetit, adresa e email-it, mirëmbajtja).

1.15 “**periudha kalimtare**” ose siç njihet ndryshe në terminologjinë ndërkombëtare (**Sunrise period**) – është periudha tranzitore/kalimtare e përcaktuar nga Autoriteti Përgjegjës por që nuk mund të jetë më e gjatë se 4 (katër) muaj në vazhdim nga dita e hyrjes në fuqi të Rregullores, gjatë së cilës personat juridik publik/privat dhe fizik tregtar do të kenë të drejtën për të regjistruar si emra domain-esh, përveç atyre emrave me të cilët njihen (p.sh. emër institucioni, emër subjekti me të cilin është bërë regjistrimi sipas legjislacionit në fuqi), apo emër marke të regjistruar nga zyrat përkatëse edhe emra që lidhen me veprimtarinë e përditshme apo aktivitetin e tyre tregtar/publik.

1.16 “**persona juridik publikë**” – janë institucion dhe ndërmarrje shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik.

1.17 “**persona juridik privat**” – janë shoqëritë tregtare, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

1.18 “**persona fizik tregtar**” – janë ato subjekte të themeluara dhe të regjistruara me këtë status në Regjistrin Tregtar, sipas legjislacionit në fuqi.

1.19 “**persona fizikë**” – janë personat (natyrorë) që në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë gëzojnë zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

1.20 “**regjistruues**” – janë subjektet e autorizuara nga Autoriteti Përgjegjës për të bërë regjistrimin e domain-eve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet dhe afati i fillimit të veprimtarisë së regjistruuesve do të përcaktohen në një akt tjetër normativ si shtesë e kësaj Rregulloreje.

1.21 **“rinovim informacioni”** – është përditesimi i informacioneve administrative të poseduesit (adresë, telefon, faks, adresë e-maili) dhe të gjitha llojeve të kontakteve (kontakt administrativ, kontakt teknik dhe kontakt pagese) që kanë lidhje me administrimin e një emri domain-i.

1.22 **“transferim”** – është veprimi administrativ që kryhet nga Autotiteti Përgjegjës për të transferuar një emër domain-i nga një posedues tek një tjetër.

1.23 **“veprime administrative”** – janë të gjitha veprimet teknike dhe administrative që kryhen nga Autoriteti Përgjegjës për regjistrimin dhe administrimin e një emri domain-i.

1.2 **“zona e emërtimit”** – është gjithë zona që përfshin një domain i nivelit të parë (psh “.al”, “.fr”, etj) dhe një ose më shumë domain-e të nivelit të dytë (nën domain-e).

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kushteve, procedurës dhe rregullave për administrimin e procesit të regjistrimit dhe administrimit teknik për qeverisjen e zonës së emrave të domain-eve (emra domain-esh nën .al dhe nën “.gov.al, mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al, .net.al”) që mbulon Autoriteti Përgjegjës.

Neni 3 Zbatueshmëria

3.1 Publikimi i Rregullores në faqen e Internetit <http://www.ert.gov.al> konsideron plotësimin e detyrimit ligjor nga ana e Autoritetit Përgjegjës të publikimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

3.2 Paraqitja e kërkesës nga aplikuesi për regjistrimin e një domain-i, si dhe pagesa e kryer sipas akteve nënligjore në fuqi, lidhur me regjistrimin ose ndonjë veprim tjetër administrativ, nënkupton njohjen dhe pranimin prej tij të kësaj Rregulloreje.

3.3 Në rast ndryshimesh të mundshme të Rregullores, efektet dhe afati i zbatimit të tyre do të jetë i menjëhershëm pas miratimit nga organi kompetent vendimmarrës i Autoritetit Përgjegjës (Këshilli Drejtues), si dhe publikimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4 Kushtet dhe kërkesat e përgjithshme

4.1 Autoriteti Përgjegjës, gjatë procesit të regjistrimit vepron në mirëbesim mbi bazën e parimit të “vetëdeklarimit”, duke marrë të mirëqenë vërtetësinë, saktësinë, autenticitetin (origjinalitetin) dhe ligjshmërinë e të dhënave të paraqitura nga aplikuesi në formularët përkatës.

4.2 Aplikuesi, përgjigjet ligjërisht mbi bazën e legjislacionit në fuqi, për vërtetësinë, saktësinë dhe autenticitetin e çdo të dhëne (informacioni) në zbatim të kërkesave të parashikuara në këtë Rregullore. Për këtë, aplikuesi deklaron me shkrim përgjegjësinë

ligjore për sa më sipër dhe se ai ka zbatuar të gjitha rregullat dhe në veçanti nuk cënon të drejtën e palëve të tjera të percaktuara në ligjin për Konkurrencen, ligjin “Për të drejtën e autorit”, pronësinë intelektuale, kulturore, etj.

4.3 Autoriteti Përgjegjës, do të veprojë duke prezumuar legjitimitetin, saktësinë, vërtetësinë dhe autenticitetin e informacionit në lidhje me të dhënat e përfutuara nga aplikuesi për regjistrimin e emrit të domain-in për të cilin aplikohet, duke disponuar në çdo kohë të drejtën e verifikimit të tyre në rast dyshimi, ankimi ose veprimi rutinë nga ana e tij.

Gjithashtu, në rastin e një cënimi haptazi të së drejtës (ligjshmërisë) ose në rastet e një përdorimi të pa autorizuar prej tij të shërbimeve të parashikuara në Rregullore, Autoriteti Përgjegjës do të veprojë sipas kësaj Rregulloreje duke mos pranuar aplikimin ose mbyllur emrin e domain-it në përdorim.

4.4 Aplikuesi, vepron duke patur parasysh detyrimin për sigurimin dhe ruajtjen e Autoritetit Përgjegjës nga ankime dhe dëme që mund të vijnë nga palët e treta, për cënim të të drejtave të tyre të parashikuar ligjërisht që vjen si pasojë a dhënies së atij emri domain-i për të cilin është aplikuar, si dhe mban përgjegjësi ligjore (administrative, civile dhe penale) në rast të vërtetimit të tyre nga organet kompetente, mbi bazën e një vendimi përfundimtar gjykatë.

4.5 Asnjë e drejtë tjetër nuk mund të burojë ose pretendohet nga dhënia në përdorim e nje emri domain-i prej Autoritetit Përgjegjës, përveç atyre të percaktuara në këtë Rregullore. Marrëdhëniet e krijuara ndërmjet aplikuesit dhe Autoritetit Përgjegjës nuk konsiderojnë dhe nënkuptojnë asnjë masë mbrojtëse në favor të të tretëve përtej atyre të parashikuara në këtë Rregullore.

Neni 5

Periudha kalimtare (Sunrise period)

5.1 Gjatë periudhës kalimtare (sunrise period), Rregullorja do të jetë e zbatueshme në tërësi përveç atyre përcaktimeve që bien ndesh me kushtet e veçanta dhe të përkohshme të parashikuara në këtë nen dhe aneksin përkatës (ANEKS 1).

a) Vetëm për këtë periudhë, kushtet e percaktuara në këtë nen, kanë përparësi dhe fuqi mbi ato të Rregullores.

b) Afati i Periudhës kalimtare – “sunrise period” do të përcaktohet me vendim të veçantë nga Autoriteti Përgjegjës, por nuk do të jetë më e gjatë se kater muaj nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

5.2 Periudha kalimtare (sunrise period), shërben për t’i dhënë mundësi subjekteve që të regjistrojnë emrat me të cilët janë regjistruar në Regjistrin Tregtar ose në ndonjë formë tjetër të njohur ligjërisht, emrat e markave të regjistruara nga ato, apo të tretë që u japin të drejtën e përdorimit të tyre, si dhe emra të tjerë me të cilët lidhet biznesi apo aktiviteti i tyre dhe që ato kanë mundësi, nëpërmjet dokumentacionit përkatës, t’i vërtetojnë si të tillë.

5.3 Kushtet, mbi të cilat veprohet gjatë “periudhës kalimtare” (sunrise period), synojnë mbrojtjen e të drejtës mbi emrat e personave juridik publikë dhe privatë si dhe

personave fizikë tregtar, emrat e markave të regjistruara që ato posedojnë, si dhe emra që lidhen me to.

Zbatimi jo korrekt i tyre ose mosveprimi nga ana e subjekteve të interesuara nuk përbëjnë përgjegjësi ligjore për Autoritetin Përgjegjës por për vetë subjektet.

5.4 Rregullat e parashikuara në “periudhën kalimtare” (sunrise period), janë të vlefshme dhe për rrjedhojë të zbatueshme vetëm për emrat e domain-eve që do të regjistrohen në zonën e “.al” dhe nën domain-et “.com.al, .org.al dhe .net.al”. Ndërsa, për nën domain-et “.gov.al, .edu.al dhe .mil.al” regjistrimi i emrave të domain-eve do të bëhet sipas neneve të përcaktuara në këtë Rregullore.

5.5 Gjatë “periudhës kalimtare” (sunrise period), përveç personave juridikë privatë dhe personave fizikë tregtar, të drejtën për të regjistruar një emër domain-i nën “.al” do ta kenë edhe personat juridikë publik, por emri që do të regjistrohet do të jetë i njëjtë ose i përafërt me emrin e institucionit apo projektit që do të ndërmerret prej tyre.

5.6 Kushtet që do të zbatohen për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve gjatë “periudhës kalimtare” (sunrise period), përcaktohen në “ANEKSI 1”, bashkëngjitur me këtë Rregullore.

Neni 6 **Kategoritë e domain-eve**

6.1 Zonat e emrave të kontrolluara nga Autoriteti Përgjegjës janë:

- a) Emrat nën .AL
- b) Nën Domain-et

6.2 Emrat nën “.al” dhe nën domain-et “.com.al, .org.al dhe .net.al” janë të lirë për t’u regjistruar nga personat juridikë publikë dhe privatë si dhe ato fizike tregtar të themeluar dhe regjistruar në përputhje me parashikimet ligjore për këtë qëllim, përveç ***periudhës kalimtare (sunrise period)***.

6.3 Nën domain-et dhe qëllimi i tyre funksional, janë:

- a) “.org.al” për personat juridikë privatë – shoqatat. Regjistrimi është lirë (përveç “periudhës kalimtare” (sunrise period)).
- b) “.com.al” për personat juridikë privatë – shoqëritë tregtare. Regjistrimi është lirë (përveç “periudhës kalimtare” (sunrise period)).
- c) “.net.al” për personat juridikë privatë dhe personat fizikë tregtar që operojnë në fushën e rrjeteve. Regjistrimi është lirë (përveç “periudhës kalimtare” (sunrise period)).
- d) “.gov.al” për personat juridikë publikë - institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi bëhet sipas kushteve të veçanta të përcaktuara në Rregullore.
- e) “.mil.al” për strukturat në përbërje të sistemit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi bëhet sipas kushteve të përcaktuara në Rregullore.
- f) “.edu.al” për institucionet (persona juridikë publikë dhe privatë) e sistemit arsimor, shkencor dhe edukativë të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi bëhet sipas kushteve të veçanta të përcaktuara në Rregullore.

6.4 Është i autorizuar vetëm përdorimi i nën domain-eve të përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 7 **Poseduesi i një emri domain-i në zonën “.al”**

7.1 Posedues të një ose disa emra domain-esh në zonën e “.al” dhe nën domain-et “.com.al, .org.al dhe .net.al”, kanë të drejtë të jenë personat juridik publikë dhe privat, si dhe personat fizik tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore, përveç *periudhës kalimtare (sunrise period)*.

7.2 Për personat fizik tregtar në kuptim të ligjit në fuqi për shoqëritë tregtare, zbatimi i së drejtës për të poseduar një ose disa emra domain-esh në zonën e “.al” dhe nën domain-et “.com.al, .org.al dhe .net.al”, sipas procedurës dhe rregullave të përcaktuara në Rregullore, do të fillojë menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 8 **Kontakti administrativ**

8.1 Me paraqitjen e aplikimit për regjistrim, aplikuesi për të qenë posedues i një emri domain-i, përveç kushteve të tjera të parashikuara në Rregullore, mund të përcaktojë dhe një “kontakt administrativ”. Poseduesi, është i detyruar ta rinovojë “kontaktin administrativ” përgjatë gjithë periudhës së përdorimit të emrit të domain-it, çdo herë që ai pëson ndonjë ndryshim.

8.2 Poseduesi i emrit të domain-it, ka të drejtë të zgjedhë si “kontakt administrativ”, veten e tij ose një person juridik privat ose person fizik tregtar/jo tregtar, pavarësisht nëse ai ka ose jo marrëdhënie të drejtpërdrejtë me të.

8.3 “Kontakti administrativ”, duhet të jetë subjekt/person rezident në Shqipëri dhe të ketë një adresë që domosdoshërisht të mundësojë korrespondencën në rrugë postare të dokumentave.

8.4 Me qënien rezident në Shqipëri të personit juridik privat, si dhe person fizik tregtar/jo tregtar nënkuptohet ekzistenca e selisë ose vendbanimit/vendqendrimit me adresë të identifikueshme në territorin e Republikës së Shqipëri në përputhje me legjislacionin përkatës për këtë qëllim.

8.5 Autoriteti Përgjegjës, nuk mban përgjegjësi dhe nuk angazhohet në asnjë rast, për zgjidhjen e konflikteve të mundëshme që mund të lindin në marrëdhëniet ndërmjet poseduesit të emrit të domain-it dhe “kontaktit administrativ”, ose të pasojave që mund të rrjedhin për shkaqe të tilla.

Neni 9

Mundësi kontakti

9.1 Është domosdoshmëri, që Autoriteti Përgjegjës të ketë mundësi të kontaktojë “poseduesin” e emrit të domain-it ose “kontaktin administrativ”, në çdo kohë sipas rastit dhe nevojës së paraqitur.

9.2 “Poseduesi” i emrit të domain-it dhe “kontakti administrativ”, detyrimisht duhet të mbajnë në mënyre të vazhdueshme përveç të tjerave dhe një numër telefoni dhe adresë e-maili të vlefshme.

9.3 Saktësia e të dhënave të kërkuara sipas këtij neni të Rregullores, është nën përgjegjësinë e poseduesit të emrit të domain-it.

9.4 Në rast të mos plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë nen edhe pas kryerjes së njoftimit nëpërmjet adresës së e-mailit të poseduesit, për të rinovuar informacionin brenda 15 ditësh kalendrike dhe masën që do të merret në rast të kundërt, Autoriteti Përgjegjës vepron me bllokimin e emrit të domain-it për një periudhë 30 ditë kalendrike dhe më pas mbyllet e tij në përputhje me nenin 26.

9.5 Me dërgimin e njoftimit në adresën e e-mailit të poseduesit, për rinovimin e informacionit, Autoriteti Përgjegjës nuk merr përsipër përgjegjësi për mosfunksionimin e e adresës së e-mailit.

Neni 10

Rinovimi i informacionit

10.1 Poseduesi i emrit të domain-it, ka për detyrë që gjatë gjithë kohës së disponimit të tij, të rinovojë informacionin e dhënë gjatë regjistrimit apo transferimit të emrit të domain-it brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve kalendrike, nëpërmjet formës përkatëse të parashikuar në Rregullore.

10.2 Nëqoftëse në rastin e një verifikimi, informacioni rezulton i parinovuar, Autoriteti Përgjegjës kryen njoftimin, nëpërmjet adresës së e-mailit të poseduesit, duke i dhënë afat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendrike për ta rinovuar atë. Më pas, në rast mosveprimi nga ana e poseduesit, Autoriteti Përgjegjës bën bllokimit e emrit të domain-it për një periudhë 30 ditë kalendrike. Në se edhe brenda kësaj periudhe të bllokimit nuk kryhet rinovimi i informacionit, Autoriteti Përgjegjës për mosveprim nga ana e poseduesit, do të zbatojë klauzolën e përcaktuar në nenin 26.

10.3 Autoriteti Përgjegjës, nuk mban asnjë lloj përgjegjësie për dëmin që mund t'i shkaktohet poseduesit si rezultat i një veprimi bllokimi apo mbyllje të emrit të domain-it/eve për shkak të mosveprimit të tij siç parashikohet në pikën 10.2.

10.4 Në procedurën e parashikuar në pikën 10.2 nuk perfshihet ndryshimi/korrigjimi i emrit të subjektit (person juridik publik/privat apo fizik tregtar) mbi bazën e të cilit poseduesi ka bërë regjistrimin e emrit të domain-it.

Neni 11

Të drejtat mbi emrin e domain-it

11.1 Poseduesi i emrit të domain-it, ka të drejtë të përdorë këtë emër gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së tij.

11.2 Poseduesi, mund ta përdorë emrin e domain-it në përdorim, vetëm për sa parashikohet dhe përcaktohet në këtë Rregullore.

11.3 Poseduesi i emrit të domain-it, merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që lidhen me regjistrimin, përdorimin dhe kryerjen e veprimeve me një emër domain-i në përputhje me kushtet dhe detyrimet e parashikuara në këtë Rregullore.

11.4 Autoriteti Përgjegjës, ka të drejtë t'i heqë poseduesit të drejtat mbi emrin e domain-it, pa kompensim, kur emri përkatës pengon procesin e rinovimit të listës së "emrave bazë" (emra të ndaluar dhe të kufizuar).

Në një rast të tillë, "poseduesi" njoftohet paraprakisht, për heqjen e së drejtës mbi emrin e domain-it, për një periudhë 6 muajore, ose e reduktuar kjo në 3 muaj, në rastin e një emergjence/nevoje të vërtetuar. Kjo kohë, është e nevojshme për t'i dhënë mundësi poseduesit për zgjedhjen e një emri tjetër domain-i dhe sigurimin e një tranzicioni normal.

Neni 12

Vlefshmëria e emrit të domain-it

12.1 Një emër domain-i është i vlefshëm për përdorim nga "poseduesi", vetëm në periudhën ndërmjet dy pagesave të njëpasnjëshme të kryera prej tij sipas përcaktimeve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

12.2 Kjo periudhë, përsëritet automatikisht, përveç rasteve kur "poseduesi" paraqet, sipas kësaj Rregulloreje dhe formës përkatëse, një kërkesë për mbyllje ose kur nuk kryhet pagesa për periudhën në vijim, sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

Neni 13

Kushtet në zonën ".al"

13.1 Sipas kësaj Rregulloreje, deri në marrjen dhe publikimin e një vendimi tjetër nga Autoriteti Përgjegjës, të drejtën për të regjistruar një emër domain-i në zonën ".al" dhe nën domain-et ".com.al, .org.al dhe .net.al", e kanë vetëm personat juridikë publik dhe privat, si dhe personat fizik tregtarë me rezidence të aktivitetit tregtar në territorin e Republikës së Shqipërisë të regjistruar si të tillë sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

13.2 Çdo subjekt (person juridik publik/privat apo fizik tregtar) që pushon së egzistuari si i tillë dhe ç'regjistrohet nga Regjistri Tregtar, në të njëjtën kohë humbet të drejtën e rinovimit të një emri domain-i të regjistruar në emrin e tij.

Neni 14

Regjistrimi i një emri domain-i në zonën .gov.al, .mil.al dhe .edu.al

14.1 Që të kryhet një regjistrim në një nga nën domain-et “.gov.al, .mil.al dhe .edu.al”, më parë duhet të provohet nga aplikuesi, që ai i përket kategorisë së përcaktuar për atë nën domain nga kjo Rregullore.

14.2 Bashkë me aplikimin për regjistrim, domosdoshmerisht duhet të depozitohet tek Autoriteti Përgjegjës edhe dokumentacioni mbështetës (provat) që vërtetojnë plotësimin e kushteve të përcaktuara në Rregullore.

14.3 Regjistrimi i një emri domain-i në zonën e një nën domain-i, nuk është i detyrueshëm për personat juridikë publik dhe privat apo personat fizike tregtar. Ata, mund të regjistrojnë një emër domain-i në zonën “.al” në përputhje me Rregulloren, *perveç periudhës kalimtare (sunrise period)*.

Neni 15

Rregulla të veçanta për nën domain-in .gov.al

15.1 Nën domain-i “.gov.al” është i rezervuar për institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë. Emri i domain-it për të cilin aplikohet duhet të përputhet plotësisht ose pjesërisht me emrin e institucionit që aplikon ose projektit që ato ndërmarrin, i cili po ashtu duhet të shoqërohet me dokumenta mbështetës.

Neni 16

Rregulla të veçanta për nëndomain-in .mil.al

16.1 Nën domain-i “.mil.al” është i rezervuar për strukturat në përbërje të sistemit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Emri i domain-it për të cilin aplikohet duhet të përputhet plotësisht ose pjesërisht me emrin e institucionit që aplikon ose projektit që ato ndërmarrin, i cili po ashtu duhet të shoqërohet me dokumenta mbështetës.

Neni 17

Rregulla të veçanta për nëndomain-in .edu.al

17.1 Nëndomain-i “.edu.al” është i rezervuar për institucionet e sistemit arsimor, shkencor dhe edukativ të Republikës së Shqipërisë.

17.2 Të drejtën për të regjistruar një emër domain-i nën “.edu.al” e kanë:

- a) Institucionet e sistemit arsimor, shkencor dhe edukativ shtetëror. Emri i domain-it për të cilin aplikohet duhet të përputhet plotësisht ose pjesërisht me emrin e institucionit përkatës ose projektit që ata ndërmarrin, i cili po ashtu duhet të shoqërohet me dokumenta mbështetës.
- b) Institucionet arsimore, shkencore dhe edukative jo publike. Këto institucione përveç formularit të aplikimit duhet të sjellin edhe një kopje të noterizuar të licensës së lëshuar sipas legjislacionit në fuqi për ushtrimin e aktivitetit perkates (license e lëshuar nga Ministria e Arsimit të Republikës së Shqipërisë). Emri i domain-it për të

cilin aplikohet duhet të përputhet plotësisht ose pjesërisht me emrin e përcaktuar në liçensë ose emrin e projektit që ata ndërmarin, shoqëruar me dokumenta mbështetës.

Neni 18

Zgjedhja e emrit të domain-it

18.1 Aplikuesi ka të drejtë të zgjedhi si emër domain-i çdo lloj emri që dëshiron, përveçse atyre emrave që bëjnë pjesë në listën e emrave të ndaluar apo të rezervuar dhe të atyre që janë regjistruar më parë nga subjekte të parashikuara në Rregullore. Aplikuesi merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të rrjedhin për këtë zgjedhje, përveç *periudhës kalimtare (sunrise period)*.

18.2 Lidhur me zgjedhjen e emrit të domain-it/ve, aplikuesi është i detyruar të zbatojë të gjitha deyrimet dhe kushtet e parashikuara në Rregullore.

Detyrimisht duhet që emri i zgjedhur të plotësojë këto kushte :

- a) Emri të mos jetë në listen e “emrave të ndaluar” ;
- b) Emri të mos jetë në listen e “emrave të rezervuar”;
- c) Emri të jetë në përputhje me rregullat sintaksore (Neni 20);
- d) Emri të mos çënojë të drejtat e palëve të tjera, në veçanti:
 - i. Të drejtën e autorit (prona letrare dhe artistike dhe/ose prona industriale)
 - ii. Ligjin e konkurrencës dhe sjelljet korrekte në marrëdhëniet tregtare/biznesit;
- e) Emrat të mos çënojë moralin publik dhe rendin, dhe në veçanti të mos përfshijnë terma:
 - i. Që çënojë lirinë dhe të drejtat themelore të njeriut, liritë dhe të drejtat vetjake, liritë dhe të drejtat politike, liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të parashikuara në Kushtetutë;
 - ii. Që mund të shkaktojnë ndonjë demtim lidhur me zhvillimin e minorenëve.
- f) Emrat, duhet të jenë të ndryshëm nga emrat e ndarjeve administrative dhe territoriale sipas ligjit përkatës në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Neni 19

Emrat e ndaluar dhe të rezervuar

19.1 Emra të ndaluar, konsiderohen emrat që sipas listës përkatëse në varësi të specifikës/natyrës së tyre, nuk mund të regjistrohen nga Autoriteti Përgjegjës si emra domain-esh.

19.2 Emra të rezervuar konsiderohen emrat që janë objekt regjistrimi me kushte të veçanta të lidhura me identitetin dhe kategorinë në të cilën klasifikohet aplikuesi.

19.3 Autoriteti Përgjegjës në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Rregullore, përgatit dhe publikon në faqen e Internetit www.ert.gov.al, listën e emrave të ndaluar dhe të rezervuar.

19.4 Emrat e “ndaluar” përfshijnë por pa u kufizuar ne to, emra me kuptim abuziv, ofendues, racist, fjalë që lidhen me krime apo sjellje të keqe si dhe ato të cilat janë në kundërshtim me zakonet e mira.

19.5 Disa shembuj të emrave të “rezervuar” janë: termat teknike të Internetit, emra që lidhen me veprime/operacione të shtetit, emrat e organizatave ndërkombëtare, emrat e qarqeve, prefekturave, bashkive, komunave, qyteteve, fshatrave, ndarjeve administrative të Shqipërisë, emrat e zonave/krahinave sipas emërtimeve të tyre popullore ose atyre të lashtësisë, si dhe monumente të kulturës apo natyrës të përcaktuara me ligj ose akte nën ligjore.

19.6 Lista e publikuar e emrave të ndaluar dhe rezervuar, përditësohet nga Autoriteti Përgjegjës mbi bazën e informacionit përkatës të marrë dhe arsyetuar në rrugë ligjore. Nuk përjashtohen rastet kur për shkaqet e mësipër të cituara Autoriteti Përgjegjës, në përgjigje të një aplikimi për regjistrimin e një emri të tillë, të shprehë mosmiratimin e arsyetuar, pavarësisht mosprezencës së këtij emri në listën e publikuar.

19.7 Autoriteti Përgjegjës, lidhur me përcaktimin e listës së emrave të ndaluar dhe listës së emrave të rezervuar, bashkëpunon me Kuvendin, Këshillin e Ministrave, Organet e pushtetit vendor, Institucionet e sistemit gjyqësor, institucione të tjera të përcaktuara me ligj ose akte nënligjore, si dhe çdo institucion ndërkombëtar ku Republika e Shqipërisë aderon.

19.8 Mosmarrëveshjet e ndryshme, që mund të lindin me të interesuarit dhe pasojat për shkak të tyre, lidhur me listën e emrave të ndaluar dhe rezervuar, nuk përbëjnë përgjegjësi ligjore për Autoritetin Përgjegjës.

19.9 Aplikuesi, të cilit i refuzohet nga Autoriteti Përgjegjës regjistrimi i emrit të domain-it të kërkuar, për shkak të përfshirjes së tij në listën e emrave të ndaluar apo të rezervuar (sipas pikës së mësipërme 19.6), ka të drejtën e ankimit pranë këtij autoriteti duke parashtruar faktet, kundërshtimet dhe pretendimet e tij për përfshirjen e emrit për të cilin aplikon në këtë listë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit. Kërkesa, detyrimisht duhet të jetë e shoqëruar me arsyetimet përkatëse.

Neni 20 **Rregullat sintaksore**

20.1 Emër domain-i është tërësia e një serie karakteresh alfanumerike që përfshin shkronjat nga A deri tek Z, numrat nga 0 deri tek 9 dhe shenjën minus “-”.

20.2 Nga pikpamja sintaksore nuk mund të regjistrohen emrat e domain-eve të mëposhtëm kur:

- a) Emrat përbëhen nga një karakter;
- b) Emrat përbëhen nga dy karaktere;
- c) Emrat fillojnë ose mbarojnë me minus “-”;
- d) Emrat përbëhen nga më shumë se 63 karaktere;
- e) Emrat fillojnë me dy karaktere alfanumerike të çfarëdoforme të pasuara nga dy minuse (formati “xy--”).

Neni 21

Regjistrimi i emrit të domain-it

21.1 Për regjistrimin e emrit të domain-it zbatohet procedura e mëposhtme:

- a) Përpunimi i aplikimeve bëhet në mënyre kronologjike, duke iu referuar kohës së depozitimit të aplikimit.
- b) Pasi plotësohet forma përkatëse (formulari për regjistrimin e një emri domain-i) në përputhje me Rregulloren, dërgohet tek Autoriteti Përgjegjës me një nga mënyrat e njohura ligjrisht. Pranohen edhe aplikimet (për regjistrim emrash të rinj domain-esh) e dërguara në rrugë elektronike (e-mail). *Aplikimet e përcjella dorazi nuk pranohen.*
- c) Çdo aplikim shqyrtohet nga Autoriteti Përgjegjës brenda 5 ditë pune nga dita e depozitimit të tij. Me përfundimin e shqyrtimit dhe pranimit të tij, aplikuesi njoftohet në rrugë elektronike me e-mail për të vijuar me ekzekutimin e pagesës sipas faturës dhe procedurës përkatëse.
Në rast të mospranimit të aplikimit, aplikuesi njoftohet me e-mail për arsyen/et e refuzimit dhe orientohet për të riaplikuar në përputhje me Rregulloren.
- d) Nga data e regjistrimit të një emri domain-i poseduesit i lihen në dispozicion 15 ditë kalendarike afat për të bërë ndryshime/korigjime të mundëshme, pasojë e ndonjë gabimi ortografik lidhur me emrin e domain-it të regjistruar ose informacionin që lidhet me kontaktet. Pas periudhës së përmendur më lart kërkesa për ndryshimin/korigjimin e emrit të domain-it konsiderohet kërkesë për regjistrim të ri për pasojë duhet të shoqërohet me një formular aplikimi për regjistrim të ri.

21.2 Aplikuesi, ka të drejtë që në çdo kohë të heqë dorë vullnetarisht nga posedimi i emrit të domain-it të regjistruar sipas kësaj Rregulloreje, duke njoftuar me shkrim për këtë, Autoritetin Përgjegjës.

Neni 22

Kriteret e regjistrimit

22.1 Regjistrimi i emrit të domain-it sipas kësaj Rregulloreje do të bëhet në bazë të parimit "kush aplikon i pari shërbehet i pari" (first come – first served), me të cilin nënkuptohet selektimi/përzgjedhja nga ana e Autoritetit Përgjegjës sipas kohës së depozitimit të aplikimit të vlefshëm.

22.2 Aktivizimi i emrave të domain-eve, pasi është kryer shqyrtimi i aplikimit dhe ka rezultuar në përputhje me Rregulloren, kryhet në ditën që Autoriteti Përgjegjës merr konfirmimin zyrtar nga banka për kryerjen e pagesës së regjistrimit.

Neni 23

Faturimi i pagesave për regjistrimin dhe posedimin e emrave të domain-eve

23.1 E drejta për posedimin e një emri domain-i, pas miratimit nga Autoriteti Përgjegjës, bëhet efektive me kryerjen e pageses përkatëse, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, nga ana e përfituesit (poseduesit).

23.2 Pagesa e parashikuar për posedimin e një emri domain-i përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

23.3 Autoriteti Përgjegjës, bën faturimin e pagesës për aplikantin/poseduesin, të cilit i njoftohet sipas njërës nga format të njohura ligjërish, për ekzekutimin e saj në llogarinë bankare të paracaktuar në faturë.

23.4 PAGESA duhet të bëhet brenda 20 ditëve kalenderike nga data e miratimit të aplikimit, përndryshe aplikimi shpallet i pavlefshëm dhe aplikanti duhet të riaplikojë nga fillimi.

23.5 Për periudhën në vazhdim, pagesa kryhet brenda 3(tre) mujorit të fundit përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së emrit të domain-it.

23.6 Për likuidimin e faturës, Autoriteti Përgjegjës, 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së emrit të domain-it/ve, bën njoftimin me e-mail të poseduesit nëpërmjet adresës së tij dhe adresës së “kontaktit të likuidimit të faturës”, të përcaktuara dhe deklaruara sipas kushteve të kësaj Rregullore.

23.6 Lidhur me dërgimin e njoftimit për kryerjen e pagesës nëpërmjet adresave të e-mailit të poseduesit dhe “kontaktit të likuidimit të faturës” të përcaktuara dhe deklaruara prej tyre, Autoriteti Përgjegjës nuk merr përsipër përgjegjësi për mosfunksionimin e këtyre adresave.

23.7 Konfirmimi i pagesës për derdhjen e saj në numrin e llogarisë së Autoritetit Përgjegjës, duhet të mbërrijë tek Autoriteti Përgjegjës deri ditën e fundit të afatit të përcaktuar në faturë për pagesën.

Nëqoftëse Autoriteti Përgjegjës, nuk e merr konfirmimin e pritur nuk mban përgjegjësi për ndonjë bllokim të mundshëm të përdorimit të domain-it sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje.

Neni 24 **Pezullimi i veprimeve**

24.1 Pezullimi, vendoset mbi veprimet (psh modifikimi, transferimi, etj.) e Autoritetit Përgjegjës për një emer domain-i sipas rasteve të përcaktuara më poshtë, por pa u kufizuar ne to:

- a) Në rastin e një urdhëri lëshuar nga gjykata për pezullimin e veprimeve, mbështetur nga një ekzekutim i përkohshëm ose me autoritetin e vendimit përfundimtar siç është parashikuar në nenin që lidhet me transferimin e detyruar, ose transferimin e të drejtës së pronësisë.
- b) Në pritje të vendimit të arbitrazhit mbi konfliktin përkatës, nëse kërkuesi i është drejtuar kësaj alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

24.2 Pezullimi, ngrin të gjitha veprimet e parashikuara për t'u kryer nga Autoriteti Përgjegjës, por poseduesi ka të drejtë ta përdorë atë, me perjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me vendim gjykate.

24.3 Mbi bazën e vendimit përfundimtar gjyqësor apo arbitrazhit për zgjidhjen e konfliktit, përfundon edhe periudha e pezullimit të veprimeve.

Neni 25

Blokimi i një emri domain-i

25.1 Autoritetit Përgjegjës bllokoi emrin e domain-it në çdo rast që identifikon një shkelje të kushteve apo kritereve të përcaktuara në këtë Rregullore, sipas rasteve të mëposhtme, por pa u kufizuar ne to:

a) Në rastin e një identifikimi të pasuksesshëm.

Fillimisht, përpara ekzekutimit të kësaj mase, poseduesi njoftohet nga Autoriteti Përgjegjës duke i lejuar një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike për të korrigjuar mosperputhjen e informacionit të paraqitur me kushtet e përcaktuara në Rregullore. Nëse poseduesi nuk vepron brenda këtij afati, atëherë Autoriteti Përgjegjës vepron duke bërë bllokimin e emrit të domain-it/ve.

b) Në se asnjë nga alternativat që mundësojnë komunikimin me kontaktin administrativ dhe poseduesin nuk është funksionale (e vlefshme) edhe pas 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike nga kryerja e njoftimit për ta rinovuar informacionin.

c) Në rastin e një vendimi gjyqësor që urdhëron bllokimin e emrit të domain-it, mbështetur nga një ekzekutim i përkohshëm ose me fuqinë e vendimit përfundimtar siç është përshkruar në nenin që lidhet me transferimin e detyruar të një emri domain-i, etj.

d) Në rastet kur në afatin e përcaktuar në Rregullore, nuk është kryer pagesa përkatëse.

25.2 Në rast mospagese të detyrimeve të parashikuara në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave dhe këtë Rregullore, Autoriteti Përgjegjës bën bllokimin e emrit të domain-it për një periudhë 30 (tridhjetë) ditë kalendarike. Gjatë kësaj periudhe, poseduesi ruan të drejtën e rihapjes së emrit ekzistues duke kryer pagesën përkatëse.

25.3 Konfirmimi i pagesës për periudhën në vijim duhet të mbërrijë tek Autoriteti Përgjegjës brenda periudhës 30 (tridhjetë) ditotë kalendarike gjatë së cilës emri i domain-it është i bllokuar, në të kundërt emri i domain-it mbyllet në përputhje me klauzolën e përcaktuar në nenin 26.

Subjekti, që humbet të drejtën e posedimit në një rast të tillë, në se kërkon përsëri të posedojë një emër domain-i, duhet të veprojë në të njëjtën mënyrë siç veprohet për regjistrimin fillestar të një emri domain-i.

25.4 Verifikimi i plotësimit të kushteve të parashikuara në këtë nen nuk përbën ndonjë detyrim të veçantë për Autoritetin Përgjegjës përtej atyre që janë parashikuar në këtë Rregullore dhe është i mundshëm në çdo rast dhe afat gjatë posedimit të emrit.

Neni 26

Mbyllja e një emri domain-i

26.1 Mbyllja e emrit të një domain-i për shkaqet e parashikuara në këtë nen, është një veprim i menjëhershëm dhe i pa revokueshëm, përveçse kur subjekti që e ka patur në përdorim domain-in e mbyllur, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e mbylljes, arrin të vërtetojë të kundërtën me prova të pakundërshtueshme ligjërish.

26.2 Kur emri i një domain-i mbyllet, ai kthehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjendje të lirë dhe mund të regjistrohet nga një aplikant i ri.

26.3 Mbyllja e një emri domain-i zbatohet:

- a) Në qoftë se situata nuk është zgjidhur pas periudhës së bllokimit 30 (tridhjetë) ditore, në mënyrë të veçantë lidhur me nenet 10 (rinovimi i informacionit) dhe 25 (bllokimi i një emri domain-i).
- b) Në bazë të një vendimi gjyqësor mbështetur nga një ekzekutim i përkohshëm ose me fuqinë e vendimit përfundimtar siç është parashikuar në nenin që lidhet me transferimin e detyruar të një emri domain-i. Ky vendim duhet që domosdoshmerisht të njoftohet/paraqitet tek Autoriteti Përgjegjës, nga pala e interesuar nëpërmjet shërbimit postar.
- c) Në rastin e një vendimi arbitrazhi për zgjidhjen e konfliktit dhe mosapelimit të tij në gjykatë sipas afatit të parashikuar ligjërish.
- d) Kur vetë emri i domain-it përfshin një shprehje, haptazi të paligjshme ose rezulton se është i përfshirë në listën e emrave të ndaluar dhe rezervuar të publikuar nga Autoriteti Përgjegjës.
- e) Regjistrimi i domain-it, lidhur me poseduesin është i paligjshëm, pavarësisht nga përdorimi i tij specifik.
- f) Poseduesi ka thyer kushtet themelore të Rregullores në mënyrë të vazhdueshme ose ka vazhduar të shkelë këto kushte pavarësisht paralajmërimeve të bëra nga Autoriteti Përgjegjës.
- gj) Kur të dhënat e poseduesit apo të kontaktit administrativ të depozituara tek Autoriteti Përgjegjës gjatë procesit të regjistrimit apo rinovimit të informacionit, nuk janë të sakta edhe 15(pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas njoftimit të Autoritetit Përgjegjës për ta bërë një gjë të tillë (rinovimin e informacionit).
- g) Kur është e pamundur të përcaktohet identiteti i poseduesit apo kontaktit administrativ nga të dhënat e paraqitura.
- h) Adresa e dhënë nga poseduesi nuk mund të kontaktohet më edhe pas 30 (tridhjetë) ditë kalendarike bllokimi (neni 25).

26.4 Poseduesi i emrit të domain-it, ka të drejtë në çdo kohë të kërkojë mbylljen e tij nëpërmjet aplikimit me formën përkatëse tek Autoriteti Përgjegjës. Me bërjen e këtij aplikimi për mbylljen e emrit të domain-it, poseduesi merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga një veprim i tillë.

26.5 Për kryerjen e veprimit të mbylljes së emrit të domain-it, me kërkesën e poseduesit Autoriteti Përgjegjës mund të kërkojë nga poseduesi një konfirmim me shkrim të dërguar me postë ose me fax.

26.6 Për rastet e përcaktuara në këtë nen, në situata të cilat nga rrethanat dhe arsyet e momentit konsiderohen të rëndësishme së veçantë dhe që kërkojnë veprim të menjëhershëm, me vendim të Autoritetit Përgjegjës mbyllja e emrit të domain-it bëhet pa njoftim paraprak.

Neni 27

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

27.1 Në çdo rast mosmarrëveshje ose konflikti të lindur midis një poseduesi dhe çdo pale tjetër të interesuar direkt ose indirekt, që lidhet me regjistrimin e një emri domain-i sipas Rregullores, për zgjidhjen e tyre, pala kërkuese do të veprojë duke iu drejtuar njerës prej zgjidhjeve alternative të parashikuara në legjislacionin shqipar në fuqi:

- a) Çdo gjykatë e rrethit gjyqësor sipas ligjit “Për organizimin e sistemit gjyqësor”; ose;
- b) Çdo forme Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi të rregulluar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

27.2 Në çdo rast mosmarrëveshje ose konflikti të mundshëm midis palëve për çështje që lidhen me emrat e domain-eve, Autoriteti Përgjegjës i përmbahet parimit të neutralitetit. Autoriteti Përgjegjës, vihet në lëvizje dhe do të veprojë vetëm në rastet e parashikuara ligjërisht si, ruajtja e konfidencialitetit apo mbrojtja e të dhënave personale, etj.

27.3 Si një përjashtim nga parimi i efektit prapaveprues, përzgjedhja e ndjekjes së procedurës së zgjidhjes së konfliktit do të aplikohet tek të gjithë emrat e regjistruar deri në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 28

Modifikimi teknik

28.1 Modifikimi teknik mund të kryhet në çdo kohë sipas kushteve të parashikuara në Rregullore për këtë qëllim.

28.2 Në rastin e modifikimeve, Autoriteti Përgjegjës i kërkon poseduesit të emrit të domain-it një konfirmim paraprak me shkrim ose me fax.

28.3 Edhe në këto raste, poseduesi i emrit të domain-it, është tërësisht përgjegjës ligjërisht për vërtetësinë dhe korrektësinë e të dhënave të depozituara prej tij tek Autoriteti Përgjegjës.

Neni 29

Transferimi vullnetar i emrit të domain-it

29.1 Emrat e domain-eve, të cilët janë në përputhje me kushtet e kësaj Rregulloreje dhe veçanërisht me kriteret e identifikimit, mund të transferohen nga një posedues tek një tjetër vetëm me miratimin paraprak të kërkesës nga ana e Autoritetit Përgjegjës.

Nuk lejohet:

- a) kryerja e transferimeve të emrave të regjistruar nën “.gov.al, .mil.al dhe .edu.al”;

b) transferimi i emrave të domain-eve në posedim gjatë *periudhës kalimtare (sunrise period)*.

29.2 Autoriteti Përgjegjës, do të aprovojë transferimin vullnetar të emrave të domain-eve, përveç rasteve të përjashtimeve të parashikuara në pikën 29.1, vetëm në qoftë se aplikuesi i ri ka siguruar prova të pranimit nga poseduesi aktual, në përputhje me procedurën e mëposhtme:

- a) Poseduesi aktual plotëson dhe dërgon tek Autoriteti Përgjegjës, sipas mënyrës/formave të njohura ligjërisht, formularin për transferim të emrit të domain-it.
- b) Me marjen e miratimit nga Autoriteti Përgjegjës aplikuesi i ri duhet të plotësojë dhe dërgojë sipas mënyrës/formave të njohura ligjërisht, formularin për regjistrim të emrit të domain-it në fjalë.
- c) Afati maksimal i paraqitjes së aplikimit është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marjes së miratimit nga Autoriteti Përgjegjës, në të kundërt emri i domain-it mbyllet në përputhje me klauzolën e përcaktuar në nenin 26.

29.3 Në rastin e një likuidimi të detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi të subjektit posedues, formulari për kërkesën e transferimit vullnetar duhet të firmoset nga personi i parashikuar ligjërisht.

Neni 30

Transferimi i detyrueshëm i emrit të domain-it

30.1 Autoriteti Përgjegjës do të kryejë një transferim të detyrueshëm të emrit të domain-it në kushtet e:

- a) Ekzekutimit të një vendimi përfundimtar gjyqësor ose arbitrazhi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- b) Zbatimit të detyrueshëm ligjërisht të një Marrëveshje Ndërshtetërore (dypalëshe ose shumëpalëshe).
- c) Ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, si një kontribut i pjesshëm asetesh në rastet e likuidimit të një shoqërie tregtare (person juridik ose fizik tregtar) sipas legjislacionit në fuqi.
- d) Si një titull ekzekutiv në kushtet e mëposhtme:
 - i) Pas njoftimit me postë që pala e interesuar i bën Autoritetit Përgjegjës për një titull ekzekutiv që lidhet me një kalim të detyrueshëm të emrit të domain-it në kuptim të Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjeve përkatëse.
 - ii) Nëqoftëse një titull ekzekutiv apo vendim i lëshuar nga një prej organeve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes ose konfliktit, është kthyer (pranuar kundërshtimi), Autoriteti Përgjegjës do të kryejë të gjitha veprimet administrative të urdhëruara, sipas kushteve të njëjta.

30.2 Autoriteti Përgjegjës nuk mund të veprojë me një aplikim, i cili nuk është në përputhje me këto kushte.

30.3 Autoriteti përgjegjës, do të veprojë vetëm në zbatim të një vendimi origjinal gjykate të paraqitur nga pala e interesuar dhe jo nga dërgimi i letrave, shkresave apo kopje të ndonjë urdhëri gjykate.

30.4 Veprimet administrative, të kryera nga Autoriteti Përgjegjës në zbatim të titullit ekzekutiv nuk sjellin asnjë përgjegjësi për të, për çfarëdo lloj arsye. Aplikanti, duhet të mbrojë dhe garantojë Autoritetin Përgjegjës ndaj çdo përgjegjësie dhe detyrimi që mund të rezultojë prej veprimeve të këtij të fundit në lidhje me ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Neni 31

Detyrimet e poseduesit të ri pas transferimit të emrit të domain-it

31.1 Procedura për kalimin e detyrueshëm të emrit të domain-it përfshin këto detyrime për poseduesin e ri përfitues:

- a) Poseduesi i ri përfitues nga titulli ekzekutiv duhet të ndjeki plotësisht të gjithë procesin dhe rregullat e vendosura nga Autoriteti Përgjegjës.
- b) Poseduesi i ri, duhet të paguajë të gjitha detyrimet lidhur me veprimet teknike dhe administrative të kalimit të detyrueshëm të emrit të domain-it, si dhe është përgjegjës për të gjitha detyrime e pashlyera nga poseduesi i mëparshëm.

31.2 Për të bërë të mundur kalimin e emrit të domain-it tek poseduesi i ri, duhet që ky i fundit të paraqesë formën e plotësuar për regjistrim të ri tek Autoritetit Përgjegjës, brenda 30(tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

31.3 Mosparaqitja e formularit përkatës për aplikim pranë Autoritetit Përgjegjës brenda 30(tridhjetë) ditëve kalendarike vijon me një bllokim të emrit të domain-it për 30(tridhjetë) ditë të tjera kalendarike dhe më pas në rast mosveprimi nga subjekti i interesuar, emri i domain-it mbyllet në përputhje me klauzolën e përcaktuar në nenin 26.

Neni 32

Konfidencialiteti dhe ruajtja e privacisë

32.1 Informacioni dhe dokumentat e mbajtura nga/ose të depozituara tek Autoriteti Përgjegjës, konsiderohen nga natyra e tyre si konfidenciale dhe nuk do të kalohen tek të tretët vetëm nëqoftëse kërkohet nga ligji apo në lidhje me një procedurë alternative për zgjidhje mosmarrëveshje ose konflikti.

32.2 Kur një alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit është përzgjedhur dhe bërë e ditur zyrtarisht, Autoriteti Përgjegjës do t'i sigurojë organit që do të merret me zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit ose personit që ai autorizon, gjithë informacionin e kërkuar dhe në mënyrë të veçantë, të dhëna që lidhen me emrin e domain-it në mosmarrëveshje/konflikt.

Autoriteti Përgjegjës, brenda mundësive do t'i sigurojë këtyre organeve, listën e emrave të domain-eve të regjistruara nga poseduesi të lidhur me padinë.

32.3 Autoriteti Përgjegjës, duke mos qënë në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi, do të respektojë në çdo rast të drejtën e poseduesit për ruajtjen e privacisë.

Neni 33

Të dhënat personale

33.1 Poseduesi i një emri domain-i, sipas kësaj Rregulloreje, ka të drejtë të disponojë gjithashtu informacionin zyrtar që ka Autoriteti Përgjegjës lidhur me të.

33.2 Poseduesi, gjithashtu ka të drejtë të kërkojë nga Autoriteti Përgjegjës korrektimin administrativ të informacionit përkatës nëse një gjë e tillë ka arsye të vërtetuara që duhet bërë. Ky shërbim është pa pagesë.

Neni 34

Detyrimet

34.1 Aplikantët, janë përgjegjës për marrjen e të gjitha masave të nevojshme për përmbushjen e kushteve të kësaj Rregulloreje dhe kujdesen nën përgjegjësin e tyre për informacionet, në të gjitha format, që jepen nga Autoritetit Përgjegjës për këtë qëllim (shpjegime, informacione online, të dhëna për veprime juridike, pyetje më të zakonshme, letra informuese, etj).

34.2 Aplikanti, ka përgjegjësi individuale ligjore për vërtetësinë, saktësinë, autenticitetin dhe mjaftueshmërinë e informacionit që ai i dërgon Autoritetit Përgjegjës.

34.3 Autoriteti Përgjegjës, ka për detyrë të kryej regjistrimin e emrave të domain-eve, sipas kësaj Rregulloreje në interes të publikut dhe në përputhje me ligjet për publikimin dhe mos diskriminimin, të përpiluara për të siguruar mbrojtjen e të drejtës intelektuale të aplikantit.

34.4 Autoriteti Përgjegjës zbaton dhe është përgjegjës për veprimet që kryen lidhur me regjistrimin e emrave të domain-ve, vetëm për sa parashikohet në këtë Rregullore.

34.5 Pavarësisht veprimeve që kryhen mbi bazën e kësaj Rregulloreje, Autoriteti Përgjegjës nuk është përgjegjës në lidhje me ndonjë të drejtë paraprake të padukshme ose për të cilën nuk është ngritur ndonjë pretendim ose padi për emrin e domainit (përveç rasteve të regjistrimeve në zonën e nën domain-eve), por është përgjegjës për zbatimin me korrektësi të kësaj Rregulloreje.

Neni 35

Garancitë

35.1 Poseduesi i emrit të domain-it në asnjë rast nuk duhet të bëhet shkak për të implikuar me përgjegjësi Autoritetin Përgjegjës ndaj çdo veprimi, akuze, pretendimi apo kundërshtimi nga çdo palë tjetër që pretendon të drejta të çdo lloji mbi emrin e domain-it, në lidhje me regjistrimin apo kalimin/transferimin e këtij të fundit.

35.2 Poseduesi i emrit të domainit është përgjegjës për të gjitha dëmet e pagueshme nga Autoriteti Përgjegjës si rrjedhojë e ndonjë konflikti, procesi gjyqësor apo çdo lloj procedurë tjetër, përfshirë këtu dhe kostot ligjore dhe ato për mbrojtjen e interesave të

saj, si dhe për kostot që Autoriteti Përgjegjës ka për zbatimin e vendimeve ligjore dhe veprimeve financiare.

Neni 36 **Modifikimi i Rregullores**

36.1 Rregullorja mund të modifikohet me inisiativën e Autoritetit Përgjegjës ose me kërkesën e palëve të interesuara kur Autoriteti Përgjegjës e çmon të bazuar dhe të pranueshme këtë kërkesë.

36.2 Amendimet e mundëshme publikohen në faqen e Internetit të Autoritetit Përgjegjës dhe bëhen pjesë integrale e Rregullores me të njejtën fuqi.

Neni 37 **Ligjshmëria**

37.1 Kjo Rregullore administrohet sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në kuptimin administrativ specifikisht nga ligji nr.8618, datë 14.6.2000, “Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe Kodi i Proçedurave Administrative.

Neni 38 **Dispozitë përfundimtare**

38.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë kalendarike pas miratimit me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së dhe publikimit të saj në faqen e internetit www.ert.gov.al

ANEKS 1

Dispozitat mbi të cilat do të bëhet regjistrimi i emrave të domain-eve gjatë periudhës kalimtare (sunrise period)

1. Gjatë periudhës kalimtare (sunrise period), nuk do të lejohet nga Autoriteti Përgjegjës transferimi i emrave të domain-eve, si një nga parimet e mbrojtjes së emrave që lidhen me një institucion shtetëror, organizëm privat apo emër marke të regjistruar prej tyre, me përjashtim të transferimeve të detyruara.
2. Dokumentat, nëpërmjet të cilave Autoriteti Përgjegjës, gjatë periudhës kalimtare (sunrise period), do të realizojë vërtetimin e dhënies të drejtë një subjekti për të regjistruar një emër domain-i në zonën “.al” me të cilin ka një lidhje të caktuar, janë të listuara më poshtë. Autoriteti Përgjegjës do të bëjë evidentimin sipas listës së mëposhtme të dokumentave, por pa u kufizuar në to:
 - 2.1 Në rastin e regjistrimit si emër domain-i të emrit që posedohet sipas Regjistrimit Tregtar apo ndonjë forme tjetër ligjore, përveç formularit të regjistrimit kërkohet paraqitja e një fotokopje të noterizuar të dokumentit që vërteton regjistrimin në fjalë (vendimin e gjykatës ose dokumentin sipas përcaktimeve të reja ligjore që zevendësojnë këtë veprim juridik)
 - 2.2 Në rastin e regjistrimit si emër domain-i të një emri marke të regjistruar apo patente, duhet të paraqitet pranë Autoritetit Përgjegjës:
 - a) Formulari për regjistrim emri domain-i;
 - b) Fotokopje të noterizuar të vendimit të gjykatës ose aktit të ri juridik në zevendësim të tij;
 - c) Çertifikata origjinale e lëshuar nga Drejtoria e Markave dhe Patentave ose fotokopje e noterizuar e saj.
 - 2.3 Në rastin kur kërkohet të regjistrohet si emër domain-i një emër marke apo patente që përfshin në zonën e mbulimit edhe territorin e Republikës së Shqipërisë, por që posedohet nga një subjekt tregtar i huaj, duhet të paraqiten pranë Autoritetit Përgjegjës dokumentat e mëposhtme:
 - a) Formulari për regjistrim emri domain-i;
 - b) Fotokopje të noterizuar të vendimit të gjykatës ose aktit të ri juridik në zevendësim të tij;
 - c) Çertifikata origjinale e lëshuar nga Drejtoria e Markave dhe Patentave apo WIPO ose fotokopje e noterizuar e saj.
 - d) Dokument, që vërteton regjistrimin si subjekt tregtar në vendin përkatës, të poseduesit të markës së regjistruar, i legalizuar sipas legjislacionit në fuqi, i përkthyer dhe noterizuar.
 - e) Deklaratë nga poseduesi i markës së regjistruar që i jep të drejtën personit juridik apo fizik tregtar shqiptar, për të regjistruar si emër domain-i emrin përkatës të markës.

2.4 Ndërsa kur si emër domain-i kërkohet regjistrimi i një emri me të cilin personi juridik apo fizik tregtar ka lidhje biznesi, duhet të depozitohen pranë Autoritetit Përgjegjës dokumentat e mëposhtme:

- a) Formulari për regjistrim emri domain-i;
- b) Fotokopje të noterizuar të vendimit të gjyqates ose aktit të ri juridik në zëvendësim të tij;
- c) Liçensë për një aktivitet të caktuar, që posedohet nga aplikuesi në të cilën të jepet qartë emri që kërkohet të regjistrohet si emër domain-i.
- d) Dokumenta të tjera që mund të vërtetojnë lidhjen midis aplikuesit dhe një emri të caktuar që synohet, nga aplikuesi të regjistrohet si emër domain-i.